

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.02.2025*

17.02.2025

Ora 11:32

RENDI I DITËS

Shqyrtimi paraprak i kërkesës nr. 1, depozituar nga Kuvendi i Shqipërisë me objekt “Kundërshtimi i pikës nr. 2 të vendimit nr. 83, datë 11.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa,
z. Ilirjan Rusmali, z. Ledio Braho
- **Stafi KQZ:** Znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:** S’ka
- **Të tjerë:** Përfaqësues nga Kuvendi

Z. E. Çefa: Mirëdita të gjithëve! Deklarojmë të hapur seancën për shqyrtimin paraprak të elementëve të formës dhe përmbajtjes të kërkesës ankimore me nr.1, e paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nga Kuvendi i Shqipërisë, me objekt ankimin apo kundërshtimin e vendimit nr.83, datë 11 shkurt 2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Sipas shortit të hedhur në KQZ relator i kësaj çështje jam unë, anëtari Elvis Çefa. Verifikojmë pjesëmarrjen, është prezent KAS-i i përbërë nga katër anëtarë, ç’ka nënkupton kuorumin për të vijuar më tej me këtë procedurë, është i krijuar ligjërisht. Prezent është administrata e KQZ-së, e cila në këtë procedim do të përfaqësojë Komisionerin Shtetëror, është prezent po ashtu përfaqësues nga Kuvendi i Shqipërisë. Ju lutem prezantohuni për efekt të proceverbalit.

Znj. M. Arbi, përfaqësuese e Kuvendit të Shqipërisë: Referuar autorizimit të sjellë dhe depozituar në administratën e KAS-it, përfaqësojmë në këtë ankim, Mimoza

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.02.2025*

Arbi, Drejtore e Shërbimit Juridik e Kuvendit të Shqipërisë, Ervina Domi, këshilltare në Shërbimin legjislativ, Ilva Valle, këshilltare e Shërbimit legjislativ, ndërkohë ka ardhur dhe vetë deputeti nismëtar i njërës nga nismat që bëhet fjalë për nismën “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 92/ 2014” të ndryshuar “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, zoti Erion Braçe.

Z. E. Çefa: Dakord, ju faleminderit! Përpara se të fillojmë, a keni ndonjë kërkesë paraprake lidhur me përbërjen e trupit gjykues apo ndonjë kërkesë tjetër procedurale?

Znj. M. Arbi, përfaqësuese e Kuvendit të Shqipërisë: Në lidhje me përbërjen ose ndonjë problem me trupin gjykues nuk kemi, ju jeni të caktuar dhe normal jeni pjesë e këtij procesi. Për sa i përket kërkesave të tjera paraprake nuk kemi, ne ato i kemi parashtruar në ankimin drejtuar KAS-it.

Z. E. Çefa: Dakord. Besoj ju jeni në dijeni të faktit që seanca e sotme është thjesht paraprake, procedurale. Pra ne do të shohim nëse janë elementët e formës dhe përmbajtjes në përputhje me Kodin Zgjedhor në mënyrë që pastaj ne caktojmë dhe seancën e themelit e cila eventualisht do të zhvillohet në një datë tjetër, kështu që debati sot do të fokusohet rreth këtyre çështjeve. Proceduralisht po ia jap fjalën përfaqësues së KQZ-së për të na parashtruar shkurtimisht rrethanat e fakteve dhe pastaj e keni dhe ju fjalën.

Znj. I. Osmanaj: Faleminderit! Atëherë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet vendimit nr. 83, datë 11.02.2025 për shqyrtimin administrativ, bazuar në denoncimin nr. 4, datë 6.02.2025 të regjistrit të denoncimeve të Koalicionit për

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.02.2025*

Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara, KRIIK, ka vendosur shqyrtimin e këtij denoncimi dhe në pikën e parë të këtij vendimi, ka vendosur pushimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit nr.4 të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara dhe në pikën 2 dhe ka vendosur t'i rekomandojë Kuvendit të Shqipërisë të mos përfshijë për shqyrtim në seancë plenare projektligjin “Për paketën e maleve” dhe projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin numër 92, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”. Në datë 14.02.2025 kemi administruar kërkesën ankimore nr. 1, drejtuar Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve me objekt “Ankim kundër pikës 2 të vendimit nr.83, datë 11.02.2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”. Nga verifikimi paraprak i elementëve të formës dhe të përmbajtjes, për këtë kërkesë ankimore konstatohet se kjo kërkesë është brenda afateve të përcaktuara ligjore. Bazuar në nenin 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor konstatojmë se kërkesa ankimore nuk i plotëson elementët e formës, sa i takon kësaj kërkesë. Në këto kushte ne e lëmë në çmim të KAS-it për të vlerësuar nëse do të kalojë ose jo në seancë shqyrtimi.

Z. E. Çefa: Dakord, ju faleminderit! Atëherë përfaqësuesi i Kuvendit, fjala për ju! Gjithmonë duke iu përmbajtur, ju lutem procedurës. Po.

Znj. M. Arbi, përfaqësuese e Kuvendit të Shqipërisë: Dëgjova parafolësen, e cila pretendon se kërkesa është konform afatit të parashikuar dhe ne e kemi respektuar si Kuvend, por pretendonim dhe elementë të formës. Natyrisht ne formën e kemi ndjekur në kontekstin e një ankimi, ankimi administrativ dhe unë mendoj që i plotëson të gjithë elementët, duke iu referuar dhe kush është kërkuesi, subjekti, palët e interesuara, objekti, adresa, pra elementë formalë të saj dhe nuk mendoj se qëndron nëse nuk është respektuar strikt neni 169, referenca që ka dhënë Kodi Zgjedhor,

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.02.2025*

elementë të cilin Kuvendi për herë të parë haset me këtë proces dhe ne kemi menduar që është në kuadër të një ankimi të përgjithshëm administrativ dhe në këtë këndvështrim është përgatitur edhe ankimi i Kuvendit drejtuar KAS-it. Për sa i përket çështjes, të cilat ne ankimojmë vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve lidhet me faktin se baza mbi të cilën u ngrit pretendimi ishte një rishikim i kalendarit të punimeve të Kuvendit që ishte bërë administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe në qoftë se duhet t'i referohesh formalisht titujve të nismave ligjore, disa prej tyre mund të të lënë atë shijen që ne ndodhemi përpara një ndalese ligjore siç është neni 91, pika 4 e Kodit Zgjedhor, ligj i cili ka miratuar vetë Kuvendi dhe me qëllim të qartë, këtë arsye përse e ka vënë, po në qoftë se do të nisemi mbi kontentin, përmbajtjes së të ligjit, efekteve që japin të dyja ligjet që janë ankimuar ato nuk kanë lidhje dhe nuk janë, nuk bien ndesh me nenin 91, pika 4 dhe ky është qëllimi dhe arsyeja pse ne si Kuvend jemi drejtuar me ankim.


Z. E. Çefa: Pa dashur t'ju ndërpres, këto janë fakte që i përkasin themelit të kërkesës.

Znj. M. Arbi, përfaqësuese e Kuvendit të Shqipërisë: Dakord.

Z. E. Çefa: Kështu që nuk është kjo faza në të cilën...T'ju dëgjojmë dhe të shprehni me hollësi për secilin nga pretendimet tuaja. Jemi vetëm tek forma dhe përmbajtje, kemi nga kolegët ndonjë pyetje? Po, zoti Rusmali!

Z. I. Rusmali: Unë kam një pyetje për administratën, në qoftë se mund të më shpjegoni, vendimi është vendim shqyrtimi i denoncimit të paraqitur nga KRIIK, denoncimit nr.1 ose të regjistruar me numër 4 ID nga KQZ-ja apo ka objekt tjetër?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.02.2025*

Znj. I. Osmanaj: Jo është vendimi i shqyrtimit, është bërë fillimisht një vendim për fillimin e hetimit administrativ për denoncimin nr.4 dhe më pas është vendimi i shqyrtimit, i cili është objekt i kërkesës ankimore, është ky që keni ju në shqyrtim.

Z. I. Rusmali: Dakord. Për projektligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, çfarë emri ka se s’po i them tani dhe projektligjin “Për paketën e maleve” ka pasur denoncim KRIIK-u?

Znj. I. Osmanaj: Jo nuk ka pasur denoncim, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dy kalendarë me të gjitha projektligjet që do i kalojë në seancën plenare dhe kemi bërë një vlerësim paraprak për të gjitha këto projektligje nëse përfshihen në fushën e ndalimit sipas dispozitës të nenit 91, pika 4, të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit të Komisionit Rregullator dhe kemi vlerësuar që këto dy projektligje janë në kushtet e ndalimit dhe i kemi rekomanduar Kuvendit të Republikës që të mos i përfshijë në seancë plenare të ardhshme.


Z. I. Rusmali: Pra nuk ka denoncim të veçantë për këto dy projektligje dhe nuk, në denoncimin që keni administruar ju që këto dy projektligje nuk përmenden.

Znj. I. Osmanaj: Jo, ky është vlerësimi ynë i kalendarit.

Z. I. Rusmali: Vlerësimi juaj jashtë objektit të çështjes.

Znj. I. Osmanaj: Duke qenë se na dërguan kalendarin, e kemi parë të arsyeshme...

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.02.2025*

Z. I. Rusmali: Po po objekti i çështjes nuk ka qenë shqyrtimi i kalendarëve, ka qenë shqyrtimi i denoncimit?

Znj. I. Osmanaj: Po.

Z. L. Braho: Përveç pyetjes që bëri zoti Rusmali unë kisha dhe një paqartësi tjetër, në qoftë se mund të na e zgjidhni, referuar dhe praktikës se dhe vendim dhe rekomandim, jam pak i paqartë! Ka pasur raste të tjera që Komisioneri me vendim ka dalë me rekomandime? Domethënë në qoftë se Kuvendi nuk e zbaton këtë rekomandimin, për aq kohë sa është rekomandim, cila është pasoja?

Znj. I. Osmanaj: Me rekomandim, në fakt është hera e parë që bëhet një vendim i kësaj natyre, kemi pasur urdhërim për ndalimin e postimeve në rrjete sociale të institucioneve, por për rekomandim sa i takon denoncimeve nuk kemi pasur, sepse këto kalendare është hera e parë, domethënë janë kaluar 3 palë zgjedhje dhe Kuvendi nuk ka dërguar ndonjëherë kalendar në KQZ mbi veprimtarinë e tyre si institucion, është hera e parë që i dërgon dhe e kemi parë të arsyeshme të bëjmë një vlerësim paraprak nëse përfshihen në fushën e ndalimit të Kodit Zgjedhor apo vendimit të Komisionit Rregullator.

Z. L. Braho: Tani kalendari i Kuvendit është publik dhe nuk besoj se duhet ta sjellin, ta kqyrni ju, megjithatë pse nuk vendosi ndalimin për shembull Komisioneri? U vu në dijeni dhe të ndalonte vijimin e procedurave të miratimit të këtyre projektligjeve, ka kompetencë Komisioneri këtë? Jo. Po rekomandimin? Dakord.

Z. E. Çefa: Po zoti Rusmali!

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.02.2025*

Z. I. Rusmali: Një pyetje tjetër prapë për administratën. Dakord ju keni marrë dhe keni shqyrtuar kalendarin, po bashkë me kalendarin keni shqyrtuar tekstet e këtyre dy projektligjeve?

Znj. I. Osmanaj: Atëherë ne këto projektligje i kemi kërkuar te faqja një për një, te faqja zyrtare e institucionit të Kuvendit, megjithatë e kemi pasur një komunikim elektronik me një përfaqësues nga Kuvendi që i kemi kërkuar të na dërgojë elektronikisht të gjitha projektligjet për të bërë vlerësimin e projektligjeve apo dhe relacioneve që kanë bashkëlidhur këto projektligje, deri tani nuk kemi marrë një feedback nga ana e përfaqësuesit të Kuvendit dhe i kemi kërkuar vetë te faqja zyrtare e Kuvendit.

Z. I. Rusmali: Kur keni marrë këtë vendim kanë qenë pjesë e shqyrtimit dy projektligjet?

Znj. I. Osmanaj: Po.

Z. E. Çefa: Kam edhe unë një pyetje në qoftë se mundem për përfaqësuesit e Kuvendit, që ka të bëjë në fakt edhe me arsyen pse keni iniciuar këtë procedim administrativ? E tha pak kolegu, efektet që ka ky vendim ndaj jush, pra pse ju duhet ta kundërshtoni një rekomandim, ka efekt, pra ju pengon në punën e përditshme, në vijimin e këtyre nismave ligjore rekomandimi i Komisionerit dhe duhet detyrimisht ta shfuqizoni këtë vendim?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.02.2025*

Znj. M. Arbi, përfaqësuese e Kuvendit të Shqipërisë: Kuvendi natyrisht kur erdhi vendimi i Komisionerit edhe në pikën 3 dhe në pikën 2 thoshte që të ndërpritet procedura parlamentare dhe të mos kalojë projektligji në shqyrtim. Kuvendi natyrisht respekton çdo vendimmarrje, aq më tepër të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të cilit i ka dhënë tagër për të menaxhuar gjithë procesin zgjedhor dhe në këtë kontekst duke e konsideruar këtë rekomandim të tij, jo të mbështetur në ligj por dhe në aktet që ka nxjerrë vetë KQZ-ja, menduam që të bëjmë ankimin në KAS pasi vetë në përmbajtjen e vendimit thoshte që ndaj këtij vendimi mund të bëhej ankim në KAS. Natyrisht Kuvendi e ka të drejtën të marrë, të zhvillojë procesin e shqyrtimit të këtyre projektligjeve, t'i shqyrtojë ato në Komisione sipas kalendarit të përcaktuar, t'i miratojë ato në seancë dhe t'i dërgojë dhe për dekretim dhe vazhdim deri në hyrjen në fuqi. Pra nuk e pengon por ne duhet të jemi korrekt me akte të cilat nxjerr KQZ-ja, një organ i cili vetë ligjvënësi e ka miratuar.

Z. E. Çefa: Dakord, qartë. Nuk kam pyetje të tjera. Patjetër, posi.

Z. E. Braçe, deputet i Kuvendit të Shqipërisë: Në kalendar gjendet dhe një nismë tjetër që është thujse e të njëjtës natyrë, është e kolegut Duka, ka dy vite e gjysmë që vjen vërdallë në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, është shqyrtuar prej Komisioneve parlamentare, disa të tjera e kanë në shqyrtim akoma dhe është thujse e njëjta nismë. Pse nuk është marrë apo pse nuk është rekomanduar?

Z. E. Çefa: Administrata e KQZ-së!

Znj. I. Osmanaj: Nga vlerësimi që i kemi bërë projektligjeve gjatë hetimit administrativ për këto dy projektligje kemi gjykuar që përfshihen në fushën e

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 17.02.2025*

ndalimit, ndoshta te relacioni bashkëlidhur, ndoshta nuk është shumë e qartë dhe për t'u kuptuar realisht ndalimi, ndoshta kur të na vihet në dispozicion nga Kuvendi, mbase do të bëjmë ndonjë vlerësim tjetër. Për momentin kemi gjykuar.

Z. E. Çefa: Dakord. Faleminderit! Ka pyetje të tjera? Nuk ka. Atëherë KAS-i pasi e diskutoi çështjen vendosi kalimin për shqyrtim në seancë të kërkesës ankimore me nr. 1, me objekt kundërshtimin e pikës 2 të vendimit nr. 83, datë 11.02. 2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Lidhur me datën e seancës së shqyrtimit në themel ne propozojmë datën 19, pra pasnesër në orën 12.00. Si e keni kalendarin ju? Dakord, atëherë seanca e shqyrtimit do të zhvillohet ditën e mërkurë në datë 19 shkurt në orën 12.00, në këtë sallë. Me kaq e deklaroj të mbyllur këtë seancë. Faleminderit!

Vendimi nr. 6

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

